



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar:** Operatori ekonomik “Gerad-A” shpk

**Adresa:** Rruga "Ded Gjo Luli", Tirane.

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e Hapur”, “Sistemimi i Lanës-Faza I”.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Sistemimi i Lanës-Faza I”.

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-69727-08-25-2020

**Fondi limit:** 30,460,341 (tridhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e dyzetë e një) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2020, miratuar me VKB Nr. 157, datë 26.12.2019 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2020 – 2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 4 (katër) muajve kalendarike duke nisur nga dita e nënshkrimit të kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 25.09.2019, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 62 datë 31.08.2020.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk**

**NUIS K71401004W**

Vlera e ofertës = 19,282,321 (nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzetë e një)pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “Gerard-A” shpk**

**NUIS L12407005L**

Vlera e ofertës = 19,453,542 (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzetë e dy) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk**

**NUIS K02003001O**

Vlera e ofertës = 19,539,512 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik “Nika” shpk**

**NUIS J76705047U**

Vlera e ofertës = 22,502,719 (njëzetë e dy milion e pesëqind e dy mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**5. Operatori ekonomik “Llazo” shpk**

**NUIS K24218401K**

Vlera e ofertës = 23,287,425 (njëzetë e tre milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

**6. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk**

**NUIS K71412003A**

Vlera e ofertës = 23,679,082 (njëzetë e tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**7. Operatori ekonomik “Shamo Konstruksion” shpk**

**NUIS L01326020F**

Vlera e ofertës = 24,843,188 (njëzetë e katër milion e tetëqind e dyzetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë)lekë pa TVSH.

**8. Operatori ekonomik “Euroalb” sha**

**NUIS K66613407H**

Vlera e ofertës = 24,879,032 (njëzetë e katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.

### **9. Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk**

**NUIS K51501008J**

Vlera e ofertës = 25,555,555 (njëzetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

### **10. Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk**

**NUIS J68310708M**

Vlera e ofertës = 27,160,585 (njëzetë e shtatë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

### **11. Operatori ekonomik “Biba X” shpk**

**NUIS K32618815N**

Vlera e ofertës = 29,851,100 (njëzetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

### **12. Operatori ekonomik “Mela” shpk**

**NUIS K62320011G**

Vlera e ofertës = 29,999,980 (njëzetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë s’kualifikuar ofertat e Operatorëve ekonomikë përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

#### **1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk**

**NUIS K71401004W**

- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 4 (katër) Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 Ton përkatësisht me targa: AA 159 HX (për të cilin nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi disponimin e tij); AA 145 RA me kapacitet mbajtës 10.7 Ton; mjete me targa AA 485 GM me kapacitet mbajtës 16.4 Ton si dhe mjete me targa SH 3625 D me kapacitet mbajtës 9.16 Ton. Pra referuar tonazheve të mjeteve të deklaruara, vetëm mjete me targa AA 145 RA plotëson kërkesat e DST, çka bie në kundërshtim Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, ku ndër të tjera parashikohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 Ton”*.
- Gjithashtu shoqëria “Kevin Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) mjete Autobot uji përkatësisht me targa TR 0553 M (për të cilin nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi disponimin e tij) si dhe AA 297 LY (për të cilin nuk ka paraqitur Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, gërma “b”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni

II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

## **2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” shpk**

NUIS J76705047U

- Operatori ekonomik “Nika” shpk ka deklaruar nenkontraktor shoqerine “ASI INVEST” shpk, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, pika 2.14.1.
- Operatori ekonomik “Nika” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamiona me kapacitet mbajtës 10-15 Ton, përkatësisht mjete me targa AA 661CN me kapacitet mbajtes 11.8 ton dhe mjete me targa AA 755 YV me kapacitet mbajtes 14.8 ton (për të cilin nuk paraqitur certifikate pronësie), çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, germen b, ku nder te tjera percaktohet se: *Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 2 (dy) kamiona me kapacitet mbajtes 10-15 Ton. (Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjete (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
- Operatori ekonomik “Nika” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Fadroma me goma, përkatësisht mjete me targa AA 673MO dhe mjete me targa KO 4907 B, per te cilet nuk jane paraqitur certifikate pronësie, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, germen b, ku nder te tjera percaktohet se: *Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 1 (një) Fadromë me goma (Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjete (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
- Operatori ekonomik “Nika” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autovinç, përkatësisht mjete me targa SH 6271E, per te cilin nuk eshte paraqitur certifikate pronësie, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, germen b, ku nder te tjera percaktohet se: *Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 1 (një) Autovinç (Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjete (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
- Operatori ekonomik “Nika” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Autobot uji, përkatësisht mjete me targa SH4498E dhe mjete me targa AA 301VR, per te cilet nuk jane paraqitur certifikate pronësie, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, germen b, ku nder te tjera percaktohet se: *Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 1 (një) Autobot uji (Për mjetet e*

*deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*

### **3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Llazo” shpk**

NUIS K24218401K

- Operatori ekonomik me ane te nje deklarate ka percaktuar Drejtuese Teknik zj.S.Toro, per te cilen nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3, *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin a)Librezë pune b) Kontratë pune e vlefshme c) Diplomë.(Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili operator duhet te përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.)”*
- Operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon mjetin Autobetoniere, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, ne te cilen eshte kerkuar disponimi i mjetit 1 (një) Autobetoniere.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Llazo” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

### **4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Shamo Konstruksion” shpk**

NUIS L01326020F

- Operatori ekonomik ”Shamo Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamionçina me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton, përkatësisht mjeti me targa AA 534 JX me kapacitet mbajtes 0.8 ton (nen kapacitetin e kerkuar) dhe mjeti me targa TR1758R, me kapacitet mbajtes 0.8 ton (nen kapacitetin e kerkuar), çka bie ne kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, ku nder te tjera percaktohet se: *Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 2 (dy) Kamionçina me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton.*
- Operatori ekonomik ”Shamo Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 1 (në) Fadroma me goma, gjate verifikimit te dokumentacionit shoqerues rezulton se nuk jane paraqitur dokumentat tekniko -ligjore, çka bie ne kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, germen a, ku nder te tjera

percaktohet se: *Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 1 (një) Fadromë me goma (Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*

## 5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Euroalb” shpk

NUIS K66613407H

- Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se **nuk është i angazhuar në kontrata të tjera** dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.....”*, pasi ka deklaruar si drejtues teknik Inxh. Zhaneta Dhiamandi e cila rezulton e angazhuar si drejtuese teknike në kontratën me objekt “Ndërtim i godinës së zjarrfikësve ”Kinostudio”.
- Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)..... kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 ton – 5 ton”*, pasi ka deklaruar 2 kamioncina me kapacitet mbajtës 3.5 ton – 5 ton nga 2 të kërkuar, përkatësisht me targa AB364AF dhe TR3893F, ku për mjetin TR3893F nuk është paraqitur akti i pronësisë, çka bie në kundërshtim me pikën 11/b ku citohet se: *“Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij **prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).***
- Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).....autobetoniere”*, pasi ka deklaruar 2 autobetoniere nga 1 e kërkuar për të cilat ka paraqitur vetëm fatura dhe jo dokumentacionin e kërkuar, çka bie në kundërshtim me pikën 11/a ku citohet se: *“Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
- Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk nuk plotëson pikën 11/h të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor”*, pasi nuk e ka paraqitur këtë deklaratë”.

## 6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk

NUIS K51501008J

- Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, lidhur me punën e ngjashme pasi ka deklaruar si të tillë kontratën me objekt “Ndërtim rrjet ujësjellësi në Shkozën e Sipërme dhe ndërtim depo uji”, për të cilën nuk ka paraqitur certifikatën e marrjes në dorëzim, çka bie në kundërshtim me pikën 1.2/a të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:..... Çertifikaten e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim”*.
- Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se : *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si më poshtë: ..... 1 (një) punonjës hidraulik (minimumi Kategoria II)”,* pasi ka deklaruar një punonjës hidraulik, të cilit, dëshmia e kualifikimi të sigurimit teknik i ka përfunduar efektet e vlefshmërisë me datë 08.04.2020
- Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se : *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).....mjeti kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 ton – 5 ton”,* pasi ka deklaruar 2 kamioncina me kapacitet mbajtës 3.5 ton - 5 ton nga 2 të kërkuar, përkatësisht me targa AA258VB dhe AA392CU, ku për mjetin me targa AA258VB nuk është paraqitur Akti I pronësisë, çka bie në kundërshtim me pikën 11/b ku citohet se: *“Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme)”*.

## 7. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Mela” shpk

NUIS K62320011G

- Operatori ekonomik ”Mela” shpk nuk plotëson pika 11, ku ndër të tjera përcaktohet se: *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 2 (dy) Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton pasi asnjë kamionçinë nuk plotëson kapacitetin e kërkuar, 3.5-5 ton, kamionçina me targë AA655YM me kapacitet 2,4 ton, kamionçina me targë AA836IR me kapacitet 1,1 ton dhe kamionçina me targë AA701MP me kapacitet 0,8 ton*

- Operatori ekonomik "Mela" shpk ka deklaruar se disponon 1 (në) Autobetoniere, gjate verifikimit te dokumentacionit shoqerues rezulton se nuk jane paraqitur dokumentat tekniko -ligjore, cka bie ne kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, germen a, ku nder te tjera percaktohet se: *Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 1 (një) Fadromë me goma (Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatori ekonomik "Gerard-A" shpk**, me adresë: **Rruga "Ded Gjo Luli", Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 19,453,542 (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzetë e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 19,539,512 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar).

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 07.10.2020.**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.